



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 23 nëntor 2017
Nr. ref.:AGJ1154/17

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI93/16

Parashtrues

Maliq Maliqi dhe Skender Maliqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 321/2012,
të 13 nëntorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u dorëzua nga Maliq Maliqi dhe Skender Maliqi nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 321/2012, të 13 nëntorit 2013, me të cilin u miratua si i bazuar revizioni i kundërpropozuesit, u prishën Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut, Ac. nr. 398/2009, i 17 korrikut 2012, dhe Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, nr. 224/2007, i 28 tetorit 2008, dhe rasti u kthye në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.
3. Aktvendimi i kontestuar iu dorëzua parashtruesve të kërkesës më 19 shkurt 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 16 qershor 2016, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 12 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
8. Më 18 korrik 2016, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të saj ia dërgoi Gjykatës Supreme.
9. Më 1 nëntor 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi një kopje të dëftesës së fletëdorëzimit të aktvendimit të kontestuar.
10. Më 31 mars 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
11. Në të njëjtën datë, Gjykata mbajti këshillime për rastin. Atëherë Kryetarja e Gjykatës, në mbështetje të rregullave 60 (1) dhe 44 (4) të Rregullores së punës, e zëvendësoi gjyqtarin Ivan Čukalović me gjyqtarin Almiro Rodrigues si gjyqtar

raportues si dhe e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova anëtare të Kolegjit shqyrtues.

12. Më 19 prill 2017, Gjykata kërkoi nga parashtruesit e kërkesës të sqaronin se cili ishte vendimi që kontestohet në kërkesën e tyre, si dhe të dorëzonin dokumente shtesë.
13. Më 28 prill 2017, parashtruesit e kërkesës dorëzuan informacione dhe dokumente shtesë në Gjykatë.
14. Më 4 shtator 2017, Gjykata mbajti këshillime dhe votoi për projektaktgjykimin e propozuar nga gjyqtari raportues.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 1 qershor 2004, Departamenti për Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë i Komunës së Fushë-Kosovës (Vendimi nr. 58) e shpronësoi ngastrën kadastrale nr. 991/1 nga paraardhësi i parashtruesve të kërkesës, me qëllim që t'i sigurohet tokë Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës.
16. Në një datë të pacaktuar të vitit 2006, parashtruesit e kërkesës, si pasardhës ligjorë, parashtruan padi në Gjykatën Komunale të Prishtinës kundër Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, SHA "Sllatina" (në tekstin e mëtejme: SHA "Sllatina"), me të cilën kërkuan kompensim monetar për patundshmërinë e shpronësuar.
17. Më 16 tetor 2006, Gjykata Komunale [N. nr. 44/2005] urdhëroi që parashtruesve të kërkesës t'u paguhet kompensimi nga SHA "Sllatina" në emër të shpronësimit. Gjykata Komunale e përcaktoi shumën që duhej paguar.
18. SHA "Sllatina" ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, duke u ankuar se shuma që duhej paguar si kompensim për shpronësimin nuk ishte përcaktuar në pajtim me ligjin.
19. Më 21 maj 2007, Gjykata e Qarkut [Ac. nr. 154/07] e miratoi si të bazuar ankesën e SHA "Sllatina" dhe e ktheu rastin në Gjykatën Komunale për rigjykim. Gjykata e Qarkut konsideroi se Gjykata Komunale nuk e kishte konstatuar saktë gjendjen faktike dhe urdhëroi si në vijim:

*"Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të kërkojë nga ekspertët bujqësor që t'i marrin parasysh kontratat e shitblerjes të vërtetuara në gjykatë, me çfarë çmimi është shitur një ari tokë në afërsi të tokës së ekspropriuar si dhe lartësia e kompensimit të tokave të ekspropriuara në afërsi të kësaj paluajtshmërie e cila është e ekspropriuar.
[...]*

Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë sipas nevojë mund të caktoj edhe superekspertizë, duke pasur parasysh edhe parimin e drejtshmërisë si dhe ndërgjegjshmërisë me rastin e marrjes së vendimit për eksproprijim."

20. Më 28 tetor 2008, Gjykata Komunale [Aktvendimi N. nr. 224/07] ua caktoi parashtruesve të kërkesës një shumë parash si kompensim për patundshmërinë e shpronësuar.
21. SHA "Sllatina" sërish parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut, duke pretenduar "(...) përcaktimin e gabuar të vlerës së parcelës".
22. Më 17 korrik 2012, Gjykata e Qarkut [Aktvendimi Ac. nr. 398/2009] e refuzoi si të pabazuar ankesën, ndërsa Aktvendimin e Gjykatës Komunale e vërtetoi në tërësi.
23. Në Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut theksohet që *"gjendja faktike është bazuar në superekspertizën e një grup ekspertëve të Fakultetit të Bujqësisë çka për momentin në Kosovë paraqet Institucionin më kredibil për dhënien e vlerësimeve të këtilla."*
24. SHA "Sllatina" më pas paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesë për revizion, duke theksuar *"shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale"*.
25. Në ndërkohë, parashtruesit e kërkesës iniciuan procedurë përmbarimore në Gjykatën Komunale në Lipjan.
26. Më 4 tetor 2012, Gjykata Komunale në Lipjan [E. Nr. 717/2012] autorizoi përmbarimin e Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë [N. nr. 224/07] të 28 tetorit 2008, dhe urdhëroi SHA "Sllatina" që t'ua paguajë parashtruesve të kërkesës shumën e specifikuar në atë aktvendim si kompensim për shpronësimin.
27. SHA "Sllatina" paraqiti prapësim ndaj këtij aktvendimi për përmbarim, duke kërkuar pezullimin e përmbarimit deri në Vendimin e Gjykatës Supreme sipas kërkesës për revizion.
28. Më 30 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Lipjan e refuzoi këtë prapësim si të pabazuar.
29. SHA "Sllatina" më pas ushtroi ankesë ndaj aktvendimit për përmbarim.
30. Më 14 qershor 2013, Gjykata e Apelit [CA. nr.77/2012] e refuzoi ankesën si të pabazuar pasi që *"me nenin 213 të LPK-së thuhet se revizioni i ushtruar nuk ndalon përmbarimin"*.
31. Më pastaj, më 13 nëntor 2013, Gjykata Supreme [Aktvendimi Rev. nr. 321/2012] e aprovoi si të bazuar revizionin e SHA "Sllatina", e anuloi Aktvendimin [Ac. nr. 398/2009] e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 17 korrikut 2012 dhe Aktvendimin [N. nr. 224/2007] e Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 28 tetorit 2008, ndërsa lëndën ia ktheu gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.
32. Në Aktvendimin e Gjykatës Supreme theksohet se *"gjykata e shkallës së parë [...] gabimisht ka zbatuar dispozitën e nenit 28 të Ligjit mbi Ekspropriimin"*

[...] në vend se të zbatojë “nenin 13 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Eksproprijimin”.

33. Më 19 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë mbajti një shqyrtim në rigjykim. Atëherë, parashtruesit e kërkesës, pasi kuptuan se ekzistonte aktvendimi i kontestuar, pohuan se ata asnjëherë nuk kishin marrë një kopje të Aktvendimit të Gjykatës Supreme. Gjykata Themelore ua dorëzoi një kopje të atij aktvendimi parashtruesve të kërkesës.
34. Përveç kësaj, Gjykata Themelore e pezulloi sine die shqyrtimin e rastit, në pritje të informatave shtesë nga SHA “Sllatina”. Në fakt, Gjykata Themelore theksoi që SHA “Sllatina” *“Obligohet [...] që pas definimit të kompetencës për përfaqësim në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencionit të Trafikut Ajror ta njoftoi gjykatën me parashtrësë të veçantë në mënyrë që e njëjta të procedoi më tutje”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

35. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se aktvendimi i kontestuar *“bie ndesh (...) me nenin 6, paragrafi 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj”*.
36. Ata pretendojnë se *“edhe pas 12 viteve atyre ju pengohet kompensimi “i menjëhershëm dhe adekuat” për tokën e eksproprijuar”,* edhe pse *“procedura për caktimin e kompensimit për pasurinë e patundshme të eksproprijuar është urgjente”*.
37. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme nuk ka mundur të marrë vendim lidhur me kërkesën për revizion, sepse *“revizioni është në kundërshtim me Nenin 2b të Ligjit Për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit Mbi Eksproprijimin, (...) ku shprehimisht përcaktohet se “kundër Aktvendimit të plotfuqishëm mbi caktimin e kompensimit nuk lejohet revizioni”*.
38. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme e Kosovës *“bie ndesh dhe shkel nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës duke i privuar [ata] nga e drejta në pronë”,* në radhë të parë, për shkak se shpronësimi i tokës në bazë të po këtij neni 46 të Kushtetutës, duhet *“të pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve eksproprijohet”*.
39. Në fakt, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se aktvendimi i kontestuar *“gabimisht ka zbatuar dispozitën e nenit 28 të Ligjit mbi Eksproprijimin [...], që nënkupton përfshirjen e “shërbimit të të ardhurave shoqërore”*. Ata theksojnë se *“me asnjë ligj, rregullore apo akt juridik nuk është përcaktuar ekzistenca dhe funksionet e këtij organi”*.
40. Për më tepër, ata ritheksojnë se aktvendimi i kontestuar është marrë në procedurë të revizionit që është *“mjet i palejuar juridik”* dhe ndikon në procedurat e rigjykimit. Ata theksojnë se *“sikur gjykata e shkallës së parë të veproj në drejtimin të cilin e ka urdhëruar Gjykata Supreme [...],*

parashtruesit e kërkesës asnjëherë nuk do të realizonin kompensimin e menjëhershëm dhe adekuat, “ngase ‘shërbimi i të ardhurave shoqërore’ nuk ekziston në Kosovë dhe nuk ka asnjë autoritet pasues cili i ka marrë përsipër këtë rol”.

41. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se dështimi për të caktuar në instancë të fundit kompensimin, për të cilin ata kanë të drejtë menjëherë dhe në mënyrë adekuate, për pronën e shpronësuar përbën shkelje të nenit 46 të Kushtetutës.
42. Parashtruesit e kërkesës konkludojnë pretendimet e tyre duke kërkuar nga Gjykata që të konstatojë se me aktvendimin e kontestuar “janë bërë shkelje të nenit 46 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 paragrafi 1 të Konventës Evropiane dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane”.

Ligji relevant

43. Ligji mbi Eksproprijimin (Gazeta Zyrtare e KSAK Nr. 21/78, ndryshuar me Ligjin për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Eksproprijimin, Gazeta Zyrtare e KSAK Nr. 46/68).

“Neni 2b.

[...]

Procedura për caktimin e kompensimit për pasurinë e patundshme të eksproprijuar është urgjente.

Kundër Aktvendimit të plotfuqishëm mbi caktimin e kompensimit nuk lejohet revizioni”

Neni 28 (i ndryshuar me nenin 13 të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Eksproprijimin).

[...]

2) “Çmimi i tregut i tokës së eksproprijuar bujqësore përcaktohet në bazë të dhënave mbi vlerën qarkulluese të cilat i jep shërbimi i të ardhurave shoqërore dhe të dhënave mbi shumën nga marrëveshjet që janë arritur për caktimin e kompensimit të drejtë për tokën e eksproprijuar në atë anë”.

Pranueshmëria e kërkesës

44. Përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata i referohet nenit 46 [Lejueshmëria] të Ligjit, që përcakton:

“Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore.”

45. Kësisoj, Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

46. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili parasheh:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

47. Gjykata po ashtu i referohet neneve 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që parashohin:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.

48. Gjykata, më tej, i referohet rregullit 36 (1) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar, ose

b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar.”

c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesit; ose

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

49. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pohojnë se Aktvendimi i Gjykatës Supreme ua ka shkelur të drejtat për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mbrojtje të pronës, të garantuara me Kushtetutë.
50. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës e parashtruan kërkesën më 16 qershor 2016, duke kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të 13 nëntorit

2013. Megjithatë, ata pohojnë se ai aktgjykim u është dorëzuar vetëm më 19 shkurt 2016. Ky fakt është konfirmuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

51. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme u anuluan aktvendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta me të cilat parashtruesve të kërkesës u ishte aprovuar kompensimi për patundshmërinë e shpronësuar dhe ishte urdhëruar përmbarimi. Përveç kësaj, me aktvendimin e kontestuar lënda u kthye në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.
52. Parashtruesit theksojnë se procedurat u kthyen në rigjykim *“ngase për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale [nga këto gjykata] ka ngelur pa u vërtetuar gjendja faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për çka aktvendimet u deshtë të prishen”*. Pra, Gjykata Supreme nuk mundi *“ta pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët”*.
53. Gjykata thekson se parimi i subsidiaritetit kërkon që para se të drejtohen në Gjykatën Kushtetuese, parashtruesit duhet të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt për të parandaluar shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë ose, nëse ka, për të korrigjuar shkeljen e tillë të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.
54. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që t’u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat e rregullta, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës. Shih Gjykata Kushtetuese, rasti KI41/09, *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010 paragrafi 16; shih po ashtu Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) rasti *Selmouni kundër Francës*, Kërkesa nr. 25803/94, Aktgjykim i 29 korrikut 1999.
55. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se procedurat në këtë rast kanë të bëjnë ekskluzivisht me kompensimin e parashtruesve të kërkesës për pronën e shpronësuar.
56. Gjykata konsideron se revizioni i ushtruar nga SHA “Sllatina” nuk ka mundur të ndërhyjë në përmbarimin e urdhëruar nga Gjykata Komunale në Lipjan, qoftë për shkak se *“me nenin 213 të LPK-së revizioni i ushtruar nuk ndalon përmbarimin”* (Aktvendimi CA. nr. 77/2012 i Gjykatës së Apelit i 14 qershorit 2013) ose për shkak se *“kundër Aktvendimit të plotfuqishëm mbi caktimin e kompensimit nuk lejohet revizioni”* (Neni 2b i Ligjit Për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit Mbi Ekspropriimin).
57. Megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se, momentalisht, rasti është pezulluar nga Gjykata Themelore në Prishtinë pa ndonjë afat të caktuar për vazhdimin e tij.
58. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se, edhe pse për këtë rast, siç pretendohet, nuk është arritur një vendim përfundimtar nga gjykatat e

rregullta, parashtguesve të kërkesës nuk mund t'u kërkohej në mënyrë të arsyeshme që të vazhdojnë me kërkesën e tyre për kompensim "të menjëhershëm" përmes gjykatave para se ata të mund të parashtrojnë ankesën e tyre për shkelje të së drejtës së tyre kushtetuese për mbrojtjen e pronës.

59. Prandaj, Gjykata konstaton se vazhdimi i tillë i rigjyimit nuk përbën mjet efektiv juridik duhet të shterohet në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës.
60. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtguesit e kërkesës saktësisht qartësojnë se cilat të drejta pretendohet se u janë cenuar me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa është e arsyetuar.
61. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtguesit janë palë të autorizuar, i kanë shteruar të gjitha mjetet efektive juridike të parapara me ligj, e kanë dorëzuar kërkesën në kohën e duhur, si dhe e kanë sqaruar me saktësi shkeljen e pretenduar të të drejtave të tyre kushtetuese.
62. Gjykata konsideron se parashtguesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
63. Rrjedhimisht, në bazë të nenit 46 të Ligjit, Gjykata konstaton se kërkesa është e pranueshme për shqyrtim të aspekteve të saj juridike përmbajtësore.

Aspektet juridike përmbajtësore të kërkesës

64. Gjykata rikujton se parashtguesit e kërkesës pohojnë shkelje (i) të drejtave të tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31.2 të Kushtetutës dhe me nenin 6.1 të KEDNJ-së; dhe (ii) të së drejtës së tyre për kompensim të menjëhershëm dhe adekuat për shpronësimin e pronës së tyre, të garantuar me nenin 46.3 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

(i) Shkelja e pretenduar e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

65. Gjykata rikujton nenin 31.2 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."

66. Gjykata po ashtu rikujton nenin 6.1 të KEDNJ-së, i cili në pjesët relevante përcakton:

"1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. [...]"

67. Gjykata vëren se parashtuesit e kërkesës në radhë të parë pretendojnë se aktvendimi i kontestuar ua ka cenuar të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, pasi që Gjykata Supreme ka urdhëruar Gjykatën Themelore të zbatojë dispozita të ligjit që pretendohet se është e pamundur të zbatohen sepse *‘shërbimi i të ardhurave shoqërore’* të cilit i referohet, nuk ekziston.
68. Për më tepër, parashtuesit e kërkesës pohojnë se vendimi i kontestuar është marrë në procedurë të revizionit që është *“mjet i palejuar juridik”* dhe që ndikon në procedurat e rigjyimit. Si i tillë, ky pretendim ka të bëjë me vlerësimin e ligjit të aplikueshëm nga ana e Gjykatës Supreme në revizionin e saj.
69. Në fakt, neni 2 (b) i Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi eksproprijimin parasheh:
- “Procedura për caktimin e kompensimit për pasurinë e patundshme të ekspropriuar është urgjente. Kundër aktvendimit të plotfuqishëm mbi caktimin e kompensimit nuk lejohet revizioni”.*
70. Gjykata merr parasysh nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, që përcakton se *“të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*
71. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson jurisprudencën e GJEDNJ-së ku konstatohet, *mutatis mutandis*, se *“juridiksioni i saj për të verifikuar se ligji nacional është interpretuar dhe zbatuar në mënyrë të drejtë është i kufizuar dhe se nuk është në funksionin e saj të zëvendësojë gjykatat nacionale, por roli i saj është më tepër të sigurojë që vendimet e atyre gjykatave nuk janë arbitrare apo në ndonjë mënyrë qartazi të paarsyeshme.”* Shih GJEDNJ rasti *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, Kërkesa nr. 73049/01, Aktgjykim i 11 janarit 2007, § 83.
72. GJEDNJ ritheksoi qëndrimin e kahershëm ku konstatohet se *“përderisa u takon në radhë të parë autoriteteve nacionale, posaçërisht gjykatave, të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit vendës, roli i Gjykatës është të verifikojë nëse efektet e një interpretimi të tillë janë në pajtueshmëri me Konventën (shih, mutatis mutandis, Miragall Escolano dhe të tjerë kundër Spanjës, nr. 38366/97, §§ 33-39, KEDNJ 2000-I). Kësisoj, edhe pse ka vetëm autoritet të kufizuar në shqyrtimin e pajtueshmërisë me ligjin vendës, Gjykata mund të nxjerrë konkluzione të duhura, sipas Konventës, aty ku vëren se gjykatat vendëse e kanë zbatuar ligjin në një rast konkret në mënyrë qartazi të gabueshme apo në mënyrë të tillë që të arrijnë në konkluzione arbitrare (shih aktgjykimin e lartpërmendur Anheuser-Busch Inc., § 83; Kuznetsov dhe të tjerë kundër Rusisë, nr. 184/02, §§ 70-74 dhe 84, 11 janar 2007; Păduraru kundër Rumanisë, nr. 63252/00, § 98, KEDNJ 2005-... (ekstrakte); Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, §§ 79, 97 dhe 98, GJEDNJ 2002-VII, Beyeler kundër Italisë [GC], nr. 33202/96, § 108, KEDNJ 2000-I; dhe, mutatis mutandis, Tsirlis dhe Kouloumpas kundër Greqisë, aktgjykim i 29 majit 1997, Raporte për Aktgjykime dhe Vendime 1997-III, §§*

59-63)”. Shih GJEDNJ rasti *Koshoglu kundër Bullgarisë*, Kërkesa nr. 48191/99, Aktgjykim i 10 majit 2007, § 50.

73. Gjykata po ashtu rikujton se “[...] Gjykata (GJEDNJ) nuk do ta vë në pikëpyetje interpretimin e ligjit vendës nga gjykatat nacionale, përveç në rast të arbitraritetit evident (shih, *mutatis mutandis*, *Adamsons kundër Letonisë*, nr. 3669/03, § 118, 24 qershor 2008), me fjalë tjera, kur vëren se gjykatat vendëse e kanë aplikuar ligjin në një rast konkret në mënyrë qartazi të gabuar apo në mënyrë të tillë që të arrihen konkluzione arbitrare dhe/ose mohim të drejtësisë (shih, *mutatis mutandis*, *Farbers dhe Harlanova kundër Letonisë* (vendim), nr. 57313/00 6 shtator 2001, dhe, megjithëse në kontekst të nenit 1 të Protokollit nr. 1, *Beyeler kundër Italisë [DHM]*, nr. 33202/96, § 108, *KEDNJ 2000-I*)”. Shih GJEDNJ rasti *Andjelković kundër Serbisë*, Kërkesa Nr. 1401/08, Aktgjykim i 9 prillit 2013, § 24.
74. Nga sa u tha më lart, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe të asaj materiale. (shih, *mutatis mutandis* GJEDNJ rasti *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, § 28).
75. Megjithatë, Gjykata vëren se aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme jo vetëm që nuk mori parasysh që “*procedura për caktimin e kompensimit për pasurinë e patundshme të eksproprijuar është urgjente*”; por para së gjithash nuk i kushtoi vëmendje faktit se “*kundër Aktvendimit të plotfuqishëm mbi caktimin e kompensimit nuk lejohet revizioni*”.
76. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se procedura e revizionit është “*mjet i palejuar juridik*” dhe po i parandalon ata që të marrin kompensimin.
77. Gjykata konsideron se Ligji mbi eksproprijimin nuk është as i paqartë, as i dykuptimshëm sa i përket revizionit; në të kundërtën, Ligji për eksproprijim në mënyrë specifike të qartë dhe të drejtpërdrejtë thotë se mjeti juridik i revizionit nuk është i lejuar kundër aktvendimeve të plotfuqishme për caktimin e kompensimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar. Kwshtu, Gjykata Supreme nuk mund të pranojë fare dhe nuk mund ta marrë parasysh një revizion të tillë.
78. Gjykata vëren se Gjykata Supreme ishte nw dijeni pwr dispozitat e Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Eksproprijimin (Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 46/86) kur theksoi “shërbimin e të ardhurave shoqërore” në rastet e caktimit të kompensimit për eksproprijimin e tokës bujqësore.
79. Megjithatë, Gjykata Supreme as nuk dha ndonjë shpjegim se përse e zbatoi një nen të atij Ligji, ndërsa shpërfilli një nen tjetër të këtij Ligji që përjashtonte juridiksionin e saj, dhe as nuk shpjegoi se pse e pranoi revizionin që, me po këtë ligj, nuk lejohet.

80. Për më tepër, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme tërësisht e shpërfilli natyrën urgjente të procedurës për caktimin e kompensimit për paluajtshmërinë e ekspropriuar, gjë që po ashtu kërkohet me Ligjin mbi Ekspropriimin, si dhe me nenin 46 të Kushtetutës.
81. Gjykata gjithashtu konsideron që interpretimi dhe zbatimi i ligjit në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme sipas revizionit janë qartazi të gabuar dhe si të tillë, kanë rezultuar me vendim arbitrar.
82. Gjykata më tej konsideron se, në këto rrethana, parashtruesit e kërkesës janë privuar nga e drejta e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga neni 31 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNJ-së dhe nga e drejta që kompensimi për shpronësimin e tokës së tyre të vendoset përfundimisht nga një gjykatë.
83. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se ka pasur shkelje të nenit 31.2 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

(ii) Shkelja e pretenduar e të drejtës së pronës

84. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë shkelje të së drejtës për mbrojtje të pronës nga neni 46.3 të Kushtetutës dhe nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, sepse ata ende nuk kanë marrë asnjë kompensim të menjëhershëm dhe adekuat për shpronësimin e tokës së tyre.
85. Gjykata po ashtu rikujton se paragrafi 3 i nenit 46 [Mbrojtja e pronës] të Kushtetutës, përcakton:

“Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet”.

86. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, që përcakton:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera”.

87. Gjykata rithekson se neni 1 i Protokollit nr. 1 përbëhet nga tri rregulla të dallueshme dhe të ndërlidhura: rregulli i parë shpreh parimin e gëzimit paqësor të pronës; rregulli i dytë trajton privimin nga prona dhe e nënshtron atë kushteve të caktuara; dhe rregulli i tretë ua njeh të drejtën shteteve, mes tjerash, të kontrollojnë shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, duke zbatuar ligje të tilla që ato i çmojnë si të nevojshme për atë qëllim. Shih rastet e GJEDNJ-së, *James, Wells dhe Lee kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesat nr. 25119/09, 57715/09 dhe 57877/09, 18 shtator 2012; *Sargsyan kundër Azerbajxhanit*, Kërkesa nr. 40167/06, 16 qershor 2015; dhe *Belane Nagy kundër Hungarisë*, Kërkesa nr. 53080/13, Aktgjykim i 13 dhjetorit 2016, § 72.
88. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se GJEDNJ gjeti shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 pasi që “*procedurat gjyqësore për kompensim kanë zgjatur pesë vjet deri më tani (...), tashmë e kanë tejkaluar kohën e arsyeshme (...) dhe janë duke vazhduar (...)*” Shih GJEDNJ rasti *Guillemin kundër Francës*, Nr. 19632/92, Aktgjykim i 21 shkurtit 1997, § 55.
89. GJEDNJ ritheksoi qëndrimin e kahershëm kur kishte gjetur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 “*në një numër rastesh kundër Bullgarisë (...) mbi bazën e vonesave të stërzgjatura në procedura, që ndikuan në të drejtën e parashtruesve për (...) kompensim (shih, për shembull, Lyubomir Popov kundër Bullgarisë, nr. 69855/01, 7 janar 2010; Naydenov kundër Bullgarisë, nr. 17353/03, 26 nëntor 2009; Vasilev dhe Doycheva kundër Bullgarisë, nr. 14966/04, 31 maj 2012; dhe Nedelcheva dhe të tjerë kundër Bullgarisë, nr. 5516/05, 28 maj 2013)*”. Shih GJEDNJ rasti *Popov dhe Chonin kundër Bullgarisë*, Kërkesa Nr. 36094/08, Aktgjykim i 17 shkurtit 2015, § 41.
90. GJEDNJ më tej konsideroi se “*autoritetet nacionale ishin përgjegjëse për vonesat e stërzgjatura të pajustificuara*” dhe se “*këto vonesa duhet të kenë vënë parashtruesit në një situatë të pasigurisë së stërzgjatur (Shih Lyubomir Popov, § 123, dhe Nedelcheva dhe të tjerë, § 82, të dy të cituar më lart)*”. Shih *Popov dhe Chonin kundër Bullgarisë*, Ibidem, § 52.
91. Gjykata rikujton se Gjykata Komunale, më 28 tetor 2008, ua caktoi një shumë parash parashtruesve të kërkesës si kompensim për paluajtshmërinë e tyre të shpronësuar. Gjykata e Qarkut e refuzoi si të pabazuar ankesën e SHA “Sllatina” dhe e vërtetoi në tërësi vendimin e Gjykatës Komunale, më 17 korrik 2012. Në pajtim me nenin 2 (b) të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi eksproprijimin, siç duket, nuk lejohet revizioni kundër aktvendimit të plotfuqishëm për caktimin e kompensimit.
92. Gjykata vëren se me vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme u miratua si i bazuar revizioni i SHA “Sllatina”, u anulua Vendimi i Gjykatës së Qarkut i 17 korrikut 2012, dhe u kthye rasti në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.
93. Megjithatë, Gjykata posa gjeti se vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk ishte në pajtueshmëri me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

94. Kësisoj, Gjykata konsideron se vendimi i mëhershëm i Gjykatës së Qarkut [Vendimi Ac. nr. 398/2009] i 17 korrikut 2012, për caktimin e shumës që duhej paguar si kompensim për eksproprijimin e pronës së tyre kishte marrë formë të prerë dhe detyruese dhe, si i tillë ishte bërë *res judicata*, pasi që asnjë mjet juridik nuk ishte i lejuar për të kontestuar atë vendim.
95. Rrjedhimisht, Gjykata po ashtu konsideron se procedurat përmbartimore të bazuara në vendimin e Gjykatës së Qarkut, që u përmbyllën me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [CA. nr. 77/2012] të 14 qershorit 2013, gjithashtu kanë marrë formë të prerë dhe detyruese.
96. Gjykata vëren se, deri më tani, nuk është paguar kompensimi për shpronësimin e pronës së parashtruesve që ishte vendosur qysh më 1 qershor 2004. Në vitin 2006, parashtruesit e kërkesës iniciuan procedura gjyqësore me qëllim që të kompensohen; megjithatë, atyre ende nuk u është paguar kompensimi. Për më tepër, si pasojë e vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, shqyrtimi i rastit është pezulluar *sine die*, pavarësisht se “*procedura për caktimin e kompensimit për pasurinë e patundshme të eksproprijuar është urgjente*” dhe pavarësisht se Kushtetuta përcakton “*sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat*”.
97. Kësisoj, Gjykata konsideron se një vonesë e tillë, pa qenë i paguar kompensimi për shpronësimin, nuk mund të konsiderohet se është në përputhje me kriterin “*e menjëhershëm dhe adekuat*” në kuptim të nenit 46.3 të Kushtetutës.
98. Prandaj, Gjykata gjen se parashtruesit e kërkesës padrejtësisht janë privuar nga prona e tyre për shkak të vonesës në dhënien e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për shpronësimin e pronës së tyre. Rrjedhimisht, është shkelur e drejta e parashtruesve të kërkesës për gëzimin paqësor të pronës së tyre, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Përfundim

99. Gjykata konsideron se Revizioni nr. 321/2012, i Gjykatës Supreme, i 13 nëntorit 2013, është bazuar në zbatim të gabuar të ligjit dhe për pasojë ka rezultuar me vendim arbitrar.
100. Gjykata konsideron se parashtruesve të kërkesës u është mohuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm në përcaktimin e kompensimit për shpronësimin e pronës së tyre, që ishte vendosur përfundimisht nga Gjykata e Qarkut [Vendimi Ac. nr. 398/2009] më 17 korrik 2012.
101. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se ka pasur shkelje të nenit 31.2 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.
102. Për më tepër, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës janë privuar nga e drejta e tyre për kompensim të menjëhershëm dhe adekuat për shpronësimin e pronës së tyre.

103. Rrjedhimisht, Gjykata po ashtu gjen se ka pasur shkelje të nenit 46.3 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 31 mars 2017,

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË, me shumicë votash, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- IV. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 321/2012, të 13 nëntorit 2013;
- V. TË SHPALLË që Vendimi i Gjykatës së Qarkut [Vendimi Ac. nr. 398/2009] i 17 korrikut 2012, për caktimin e shumës që duhej paguar si kompensim për pronën e shpronësuar është i formës së prerë dhe detyruese dhe, si i tillë, është *res judicata*.
- VI. TË SHPALLË që Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [CA. nr. 77/2012] i 14 qershorit 2013, për përmbarimin është i formës së prerë dhe detyruese dhe, si i tillë, është *res judicata* dhe i përmbarueshëm;
- VII. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë, që në bazë të nenit 116 (1) të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës së Gjykatës, ta njoftojnë Gjykatën, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj, në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e aktgjykimit të kësaj Gjykate;
- VIII. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të zbatimit të këtij urdhri;

- IX. TUA KUMTOJË këtë vendim parashtresve të kërkesës, Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- X. TA PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- XI. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi